



Bashkia Tiranë
Qendra Ekonomike e Zhvillimit Dhe Edukimit Të Fëmijëve.
Sektori i Kujdesit Psiko-social

FËMIJËT dhe LOJA



Si të luani me fëmijën tuaj që ai/ ajo të mësojë?

Tiranë 2019

1 Tema: "Fëmijët dhe loja. Si të luani me fëmijën tuaj që ai/ajo të mësojë?"/ A. Xhemali dhe J.Çeça

© Ky material është produkt i specialistëve të Sektorit të Kujdesit dhe Zhvillimit Psiko-Social në Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të fëmijëve (QEZHEF), Bashkia Tiranë.

Ai është përgatitur për tu përdorur si material konsultues për klasat prindërore dhe takimet trajnuese dhe psiko-edukuese me stafet edukatore në çerdhet publike të Tiranës.

Përgatitën materialin:

Msc. Albana Xhemali

dhe

Msc. Jonida Çeça

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF)

Adresa: Rruga e Barrikadave, Tiranë

Tel: +355 4 2222 991

e-mail: femijet@tirana.al

Website: femijetetiranes.al

Facebook: Fëmijët e Tiranës

PËRMBAJTJA;

Hyrja.....	4
1. Çfarë është loja? ("Si të kuptojmë botën e një fëmije"?).....	5
2. Çfarë nuk është lojë?	6
3. Llojet e lojës dhe rëndësia e tyre.	7
4. Loja dhe zhvillimi: (<i>Fëmijët rriten dhe qasja e tyre ndaj botës ndryshon</i>)......	11
5. Rëndësia e lojës dhe ndikimi i saj në zhvillim.....	12
6. Loja në natyrë, kalimi nga ekranet në lojën e vërtetë.....	15
7. Roli i prindit në lojën e fëmijës.....	17
8. Disa aktivitete që mund të zhvilloni me fëmijën tuaj;	18
9. Loja dhe fëmijët me nevoja të veçanta:.....	21
10. Edukimi dhe edukatorët në raport me fëmijën dhe lojën.....	24

***"LOJA ËSHTË OBJEKTIVI PËRMES
TË CILIT FËMIJËT PËRJETOJNË BOTËN E TYRE
DHE ATË TË TË TJERËVE."***



Hyrja

Eja në botën time:

Loja mund të konsiderohet e barazvlefshme me fëmijë dhe fëmijëri. Jeta e një fëmije nuk mund të konceptohet pa lojën dhe imagjinatën. Pikërisht përmes këtyre dy proceseve fëmija zhvillon bazat e njohjes dhe shpalos dijen e tij. Loja na tregon shumë rreth zhvillimit të një fëmije, temperamentit të tij, dinamikave familjare dhe mënyrës se si ai percepton botën që e rrethon. Loja ndihmon kujdestarët, prindërit, terapistët të krijojnë një marëdhënie besimi me fëmijën duke iu përshtatur gjuhës së tij. Mënyra se si fëmija manipulon objektet që në foshnjëri, mënyra se si një tre- vjeçar luan " me sikur" na tregon shumë për zhvillimin e tij mendor. Duke vëzhguar fëmijët në çerdhe është vënë re se një pjesë e madhe e fëmijëve kanë interes ndaj mjeteve elektronike si celularët dhe shumë pak lojra tërheqin vëmendjen e tyre. Një numër i madh i tyre luajnë në mënyrë të vakët me lojra, i shikojnë ato, por nuk arrijnë të zhvillojnë një lojë imagjinare. A mund të thuhet se teknologjia tashmë ka arritur të "shuaj" imagjinatën? Ndoshta, por për fat të mirë ka ende fëmijë të cilët arrijnë të krijojnë situata , të luajnë "me sikur" dhe në disa raste të përfshijnë dhe fëmijët e tjerë në lojën e tyre. Nuk ka gjë më të bukur se sa të shikoni fëmijën tuaj të luaj, dhe të zbuloni më shumë rreth botës së tij. Ndonjëherë na ndodh të ulemi dhe të vëzhgojmë të gjithë fëmijët, i lutemi edukatores që të mos i pengojë ata, shohim që një fëmijë jo shumë aktiv, i cili nuk i thotë vjershat në grup papritur në mënyrë krejt natyrale po luan, është vendosur në rolin e babait, nënës, mësueses etj, po krijojnë një situatë, po i jep asaj një zhvillim dhe një zgjidhje inteligjente. Në lojë ai po tregon të gjitha ato që di, potencialin e tij dhe përmes saj po shpreh vetveten. Në këtë lojë ai do të jetë aty në botën e tij, i pa ndikuar nga të rriturit. Kjo është aftësia e një fëmije dhe e vetmja mënyrë për të mësuar. Duke luajtur me fëmijën tuaj do mësoni shumë se si ai e ka kaluar ditën, do i mësoni atij të përballet me situata të cilat ndoshta nuk i has në jetën e përditshme, do i prezantoni një botë të madhe në dhomën e tij të vogël. Çdo lodër është e rëndësishme dhe çdo formë loje duhet përdoruar. Loja me fëmijët tuaj duhet të jetë e larmishme, aktive, spontane dhe fëmija juaj duhet të jetë iniciuesi dhe drejtuesi i saj. Ju mund të jeni vëzhgues dhe nëse fëmija ju lejon pse jo pjesëmarrës në lojën e tij.

1. Çfarë është loja? ("Si të kuptojmë botën e një fëmije"?)

Loja konsiderohet si një pjesë e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve. Fëmijët mësojnë për botën përmes lojës. Fëmijët janë qenie sociale të cilat dëshirojnë të ndërveprojnë dhe komunikojnë. Kur fëmijët luajnë ata mësojnë për veten dhe për të tjerët. Nëse fëmijët kanë një "punë" ajo është loja. Përmes lojës ata janë në gjendje të vetërregullojnë gjëndjen e tyre emocionale, të bashkëveprojnë me bashkëmohatarët, edukatorët, dhe mjedisin rrethues. Loja është pjesa më e mrekullueshme e një fëmije.

"Fëmijët e shohin lojën e tyre si diçka serioze dhe ata shpenzojnë shumë energji dhe emocione në të. E kundërta e lojës nuk është çfarë është serioze, por çfarë është e vërtetë". Gjithashtu Frojd ka pohuar se loja është puna e fëmijëve, dhe angazhimi në të kërkon që fëmijët të shpenzojnë shumë energji. "Loja e fëmijës nuk është një imitim. Loja është një punë psikike e veçantë. Është një lloj makinerie që i jep subjektit kënaqësi." (Freud,1920)¹

Kjo do të thotë se për fëmijët loja është një akt i rëndësishëm rreth të cilit ai shënon gjithë qënien e tij. Ajo kurrsesi nuk mund të jetë në përputhje me realitetin pasi krijohet nga imagjinata e fëmijës dhe situatat në lojë janë të gjitha të krijuara prej tij. Fëmijët luajnë në mënyrë spontane, në lojë tregojnë atë çfarë ata dinë për botën, mënyrën se si i perceptojnë situatat dhe kjo është diçka që u përket tërësisht dhe vetëm atyre

Loja është konsideruar si puna dhe ushqimi i fëmijëve. Është profesioni i tyre. " Është objektivi përmes së cilit fëmijët përjetojnë botën e tyre dhe atë të të tjerëve."(Goldstein, 2012, p. 4)². Loja vë në aktivitet të gjithë organizmin gjë që e ndihmonë fëmijën të zhvillojë disa aftësi të rëndësishme përgjatë rritjes, gjithashtu është një proces aktiv dhe konstruktiv (Mead, n.d.; Emslie & Mesle, 2009)³. Fëmijët si natyrë janë kurioz dhe të gatshëm për të eksploruar, dhe për këtë arsye loja e fëmijëve tenton të jetë spontane dhe e ndryshueshme. Nuk ka të drejta apo të gabuara në lojë, prindërit dhe edukatorët duhet tu sigurojnë fëmijëve të gjitha lehtësirat që ata të mund të luajnë. Loja karakterizohet më së shumti nga procesi se sa nga produkti, të qenit fleksibël nga aspekti kognitiv u lejon fëmijëve të eksplorojnë interesat e tyre, të shprehin kënaqësi, të tregojnë frikërat dhe zhgënjimet e tyre (Smith, 2013; Edwards, 2017; Miller & Almon, 2009)⁴.

Të lejojsh fëmijën të luaj në disa momente është mëse e rëndësishme për të krijuar lidhjet dhe mardhëniet me të tjerët. Loja është e rëndësishme pasi kontribuon në të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijës. Loja ndihmon në zhvillimin fizik pasi kur fëmijët luajnë përdorin si motorikën fine dhe atë globale. Loja zhvillon aftësitë kognitive përmes të mësuarit, zgjidhjes së problemeve, kujtesës dhe marrjes së vendimeve. Loja ndikon në zhvillimin emocional të fëmijës duke e lejuar atë të jetë më i vëmendshëm ndaj disa emocioneve dhe ti menaxhoj ato në mënyrë efektive. Loja në kontekstin social është e rëndësishme pasi nëpërmjet saj fëmijët zhvillojnë marrëdhëniet, besimin dhe krijojnë lidhjet të cilat do ti përdorin gjatë gjithë jetës së tyre. Loja nxit imagjinatën duke i lejuar fëmijët të jenë kreativ dhe të krijojnë situata hipotetike. Gjithashtu loja nxit dhe zhvillonë aftësitë gjuhësore te fëmijët. Loja duhet të konsiderohet si një pikë e rëndësishme në edukimin e fëmijës sepse vetëm përmes lojës

1 S. Frojd, " Përtej parimit të kënaqësisë" (1920)

2Goldstein, J. "Play in Children's Development, Health, and Eëll-being".

3Mead, S. (n.d.). "How Do Children Learn Through Play?", Emslie, A., & Mesle, C. "Play: The use of play in early childhood education".

4Smith, P.K. "Play: Synthesis. In the Encyclopedia of Early Childhood Development"; Edwards, S. "Play-based Learning and Intentional Teaching: Forever Different?", Miller, E., Almon, J. "Crisis in Kindergarten: Ehy Children Need Play in School."

fëmijët janë në gjendje të zbulojnë se kush ata do të jenë".

Loja karakterizohet nga disa cilësi si: kuptueshmëria, afekti pozitiv (kënaqësia), motivim i brendshëm, liria, rregullat e jashtme dhe ndërveprimi social.(Unicef and Lego Foundation,2018)⁵

Kuptueshmëria -Fëmijët luajnë për t'i dhënë kuptim botës përreth tyre dhe për të gjetur kuptime në eksperiencat e tyre duke i lidhur me dijet që ata tashmë i zotërojnë. Përmes lojës fëmijët shprehin dhe ndajnë kuptimet e tyre në lidhje me përvojat.

Afekti pozitiv - i referohet kënaqësisë dhe gëzimit të fëmijëve gjatë lojës i cili shprehet përmes qeshjes, të kënduarit dhe gëzimit. Sikurse të rriturit, edhe fëmijët kërkojnë vazhdimisht të përjetojnë përvoja pozitive dhe punojnë për t'i përjetuar ato. Kënaqësia e fëmijës gjatë lojës ndërlihet edhe me angazhimin aktiv të tij, përfshirjen e thellë të fëmijëve në lojë dhe përqendrimin e plotë.

Motivimi i brendshëm - faktorë të ndryshëm mund ta motivojnë fëmijën për të luajtur, për të fituar një perspektivë të re familjare, për të fituar zotërim ndaj objekteve të reja, nevoja për të punuar me ndjenjat, për të fituar një këndvështrim të ri për një përvojë të njohur, duke arritur zotërim me objekte të njohura. Edhe pse motivimi vjen nga fëmijët, të rriturit duhet të krijojnë një mjedis të sigurt, të mbështesin dhe ndihmojnë fëmijën gjatë lojës.

Liria dhe rregullat e jashtme - fëmijët gjatë lojës vendosin rregulla, udhëheqin rolet dhe krijojnë marrëdhënie. Loja dhe të mësuarit nuk janë të qëndrueshme. Fëmijët luajnë për të praktikuar aftësitë e tyre, për të vërtetuar hipoteza dhe eksploruar sfida të reja, duke çuar drejt një të mësuarit më të thellë.

Ndërveprimi social- Loja i mundëson fëmijëve të shkëmbejnë ide, të kuptojnë të tjerët gjatë ndërveprimit, të ndihmojnë njëri- tjetrin duke nxitur kështu bashkëpunimin dhe krijimin e mardhnieve sociale.



2. Çfarë nuk është lojë?

Aktivizmi në sporte, përdorimi i teknologjisë, lojrat e tavolinës nuk mund të konsiderohen "lojë" (Armstrong, 2015)⁶. Sportet kompetitive nuk mund të konsiderohen si lojë pasi në to fëmija duhet të ndjek disa rregulla strikte. Në lojën e vërtet rregullat vendosen nga fëmijët dhe të gjithë fëmijët mund të luajnë dhe të vendosin rregullat e tyre.

Fëmijët sot janë dhe po bëhen gjithnjë e më shumë të lidhur me mjetet teknologjike, por përdorimi i këtyre mjeteve inteligjente për të " luajtur" nuk është lojë e vërtetë. Loja lejon bashkëpunimin me të tjerët, fëmijët përmes lojës kuptojnë çfarë u pëlqen dhe çfarë nuk u pëlqen. Përdorimi teknologjisë nuk na jep këtë mundësi.

Gjitashtu, përfshirja në lojrat e tavolinës is shah, monopoli nuk mund të konsiderohen lojra, e para sepse nuk inciciohen nga fëmija dhe gjithashtu reduktojnë kreativitetin (Armstrong, 2015). Loja është

⁵Unicef and Lego Foundation, "Learning through play Strengthening learning through play in early childhood education programmes."

⁶T Armstrong. What Children's Play is not".

6 Tema: "Fëmijët dhe loja. Si të luani me fëmijën tuaj që ai/ajo të mësojë?"/ A. Xhemali dhe J.Çeça

vullnetare dhe e vetë-drejtuar, dhe nuk mund të drejtohen nga prindërit apo mësuesit (Gray, 2017)⁷.

3. Llojet e lojës dhe rëndësia e tyre.

Përvoja e parë e fëmijës me lojën ndodh atëherë kur i rrituri fillon të kryejë imitime facial ose lojra si "ta- ta" në mënyrë që fëmija të qeshë. Por, në këtë rast nuk mund të flasim për lojë të vërtetë pasi ajo nuk inciohet nga fëmija dhe ndodh të mos jetë reciproke.

Lojrat e para të fëmijëve konsiderohen si lojra vetmimtare, dhe kanë të bëjnë me eksplorimin e objekteve që fëmija ka përreth. Foshnjat janë ato që eksperimentojnë në mjedisin rrethues (lojra eksploruese). Kështu psh. nëse keni vënë re një fëmijë 7-8 muajsh në çerdhe apo në shtëpi, ndodh të hedhë objektet që bëjnë zhurmë në dysheme dhe më pas pret që ju t'ia ktheni atë. Gjithashtu, këta fëmijë e shikojnë objektin me vëmendje dhe e rrotullojnë atë në të gjitha anët. Ndërkohë, ndryshe ndodh me fëmijët më të rritur, ata janë të aftë të kontrollojnë dhe manipulojnë mjedisin përreth në shërbim të lojës që ata zhvillojnë (lojë e arritur). Loja vetmimtare zakonisht shoqërohet nga loja paralele, të luash pas por jo së bashku. Një shembull të tillë e vëmë re shpesh te grupet pas-latante në çerdhe, ku fëmijët vrapojnë pas njëri-tjetrit, ose ndjekin njëri-tjetrin, por mungon bashkëveprimi midis tyre (2-3 vjeç). Kjo fazë e lojës ndikon më pas në zhvillimin e asaj që quajmë lojë sociale (3 ose 4 vjeç). Loja sociale ndryshon nga lojrat që fëmija juaj është përfshirë deri më tani, është më komplekse dhe përfshin shumëllojshmëri aktivitete të thjeshta (lojra të tilla mund të përmendim ndërtimin e trenit ose qytetit me lego, si të ndërtojmë së bashku një kështjellë prej rëre etj). Kjo fazë e zhvillimit të fëmijës që shtrihet nga loja vetmimtare, te ajo sensomote dhe loja me sikur, ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive kognitive të fëmijës (Brown 2009, Else 2009, Smith 2010)⁸. Urgjenca e lojës me sikur në veçanti është një fazë kritike e fëmijëve që i ndihmon ata të zhvillojnë të menduarit simbolik. Mund të themi se **çdo aspekt i rritjes së fëmijës ndikohet nga loja.**

Llojet e lojës	Shembuj
Fizike	Lojrat që zhvillohen në park, oborr, si hedhja, kërcimi, vrapi, ecja, loja me top etj.
Loja me objekte	Të luash me lodra, pazëll, kukulla etj.
Loja simbolike:	Kjo formë e lojës fillon të shfaqen në moshën 12 muajshe kur fëmija fillon të përdorë tingujt si një formë komunikimi.
Pretenduese	Bëjmë sikur vishemi, bëjmë sikur gatuajmë, vendosja në role si princesh, doktor etj.
Loja sociale	Të ndërveprojë me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, të mësojë se si të japë dhe marrë, të ndajë me të tjerët dhe të ndërtojë marrëdhënie.

⁷Gray, P. *What Exactly Is Play, and Why Is It Such a Powerful Vehicle for Learning?*

⁸Brown, (2009). *Play*. Penguin; Else, Perry. (2009). *The value of play* dhe Smith, P. K. (2010). *Children and Play*. Wiley-Blackwell.

Loja me rregulla	Loja me shami.
Konstruktive	Të përdorësh kubat, lego, formuese për të ndërtuar një kështjellë.

Loja fizike. Loja fizike ndodh kur fëmija fillon të ecë dhe i duhet të përdorë aftësitë e tij motorike. Disa aftësi të mëdha motorike të fëmijët janë ecja, vrapimi, hedhja ose kërcimi. Fëmijëve të vegjël u pëlqenë të luajnë në mjedise të hapura si parqe, oborr etj.

D. Whitebread, D. Neale, H.Jensen, C. Liu, S. L. Solis, E. Hopkins; K. Hirsh-Pasek dhe J. Zosh (2017)⁹ në një rishikim të 20 studimeve rreth ndikimit të lojës në zhvillimin e fëmijëve panë se loja fizike kishte një sërë benefitesh në zhvillim:

- Loja fizike ndikon pozitivisht në shëndetin dhe mirëqenien fizike të fëmijëve, kjo pasi ajo kërkon që fëmija të kryejë disa lëvizje fizike.
- Duket se ka evidenca të cilat tregojnë për një marrëdhënie midis lojës fizike dhe arritjeve akademike, aftësive vetë- rregulluese dhe kompetencave sociale.
- Lojrat fizike si "loja me të kapura" ose "të luajmë luftash" e ndihmojnë fëmijën të zhvillojë kompetencat sociale dhe emocionale dhe gjithashtu ka një ndikim indirekt në arritjet akademike.
- Loja në mjedise të hapura u lejon fëmijëve jo vetëm të zhvillojnë aftësitë e tyre motorike, por gjithashtu të qetësohen dhe të pushojnë.
- Gjatë aktiviteteve në parqe fëmijët ndërmarrin përsipër aktivitete të rrezikshme si të ngjiten në pemë, në shkëmb/ mur (Gray, 2017)¹⁰. Të qenit aktiv përgjatë ditës i lejon fëmijët të harxhojnë më shumë energji dhe të jenë më të përqëndruar në aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në grup.

Loja me objekte. Loja me objekte fillon sapo fëmija është i aftë të kapë dhe mbajë objektet në duar dhe fillon t'i eksplorojë ato. Sjelljet e hershme eksploruese janë **kafshimi, rrotullimi i objekteve, fërkimi, hedhja dhe kapja**. Kjo gjithashtu mund të cilësohet si lojë senso motorre ku fëmijët fillojnë të eksplorojnë objektet dhe materialet rreth tyre. Në moshën 18-24 muajshe fëmijët fillojnë të organizojnë objektet duke i klasifikuar ato më vonë.

- Gjatë lojës me objekte fëmijët zhvillojnë koordinimin sy- dorë.
- Përdorimi i lodrave nxit funksionet kognitive dhe aftësitë në zgjidhjen e problemeve. (White, 2015)¹¹. Lejojini fëmijët tuaj të përdorin objekte të larmishme si topa, çanta, pazëlla, lugë për të zhvilluar koordinimin sy-dorë. Të luash me top me fëmijën e ndihmon atë të fokusohet në hedhjen dhe kapjen e topit. Loja me pazëll përveçse është argëtuese, ndihmon në zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme dhe koordinimin sy-dorë.
- Gjithashtu, aktivitete të tilla të cilat zhvillohen dhe nga edukatorët në çerdhet publike të Bashkisë Tiranë si ngjitja e objekteve në letër, dritare etj, i ndihmojnë fëmijët jo vetëm në nxitjen e koordinimit sy-dorë, por edhe në zhvillimin e motorrikës fine.
- Loja me objekte ka ndikim në nxitjen e disa aftësive vetërregulluese dhe në zhvillimin

⁹The role of play in Children's development: A review of the evidence, 2017.

¹⁰Gray, P. "What Exactly Is Play, and Why Is It Such a Powerful Vehicle for Learning? Topics in Language Disorders".

¹¹White, R. "The Power of Play: A Research Summary on Play and Learning". 1-31.

strategjive të duhura për zgjidhjen e problemeve.

- Disa studime kanë dhënë evidenca të rëndësishme rreth ndikimit të lojës me objekte në zhvillimin gjuhësor, aftësive matematikore dhe hapsinore. (D. Whitebread, D. Neale, H.Jensen, C. Liu , S. L. Solis, E. Hopkins; K. Hirsh-Pasek dhe J. Zosh, 2017).

Loja simbolike: Kjo formë e lojës fillon të shfaqet në moshën 12 muajshe kur fëmija fillon të përdorë tingujt si një formë komunikimi (megjithatë duket se fëmijët fillojnë të luajnë me tingujt në një moshë më të hershme, kur fillojnë gugatjet e para si dhe të përdorin gjeste të cilat janë një formë komunikimi rreth nevojave e tyre gjatë vitit të parë të jetës). Gjatë foshnjërisë, këto simbole fillestare do të përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të lojës së fëmijës dhe procesit të të mësuarit kur fëmija të prefeksionojë më tej sistemin e tij simbolik, ku përfshihet gjuha e folur, numërimi, muzika etj.

Loja pretenduese. Gjatë lojës pretenduese fëmijët janë të aftë të krijojnë skenare nga më të ndryshmet të cilat mund të jenë një rishfaqje e një situatë të përditshme ose thjesht imagjinata e fëmijës. Fëmijët në moshën 30- 36 muajsh në çerdhe janë të aftë të marrin pjesë pjesërisht në realizimin e një loje dramatike.

- Loja pretenduese mund të jetë një mënyrë që fëmija të zhvillojë aftësitë sociale dhe kognitive.
- Loja pretenduese nxit zhvillimin e aftësive kognitive dhe gjuhësore sepse kur fëmija merr pjesë në një skenar të caktuar, ata komunikojnë dhe bashkëveprojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin.
- Ka evidenca të qënësishme që tregojnë se disa forma të lojës pretenduese, veçanërisht ato që kanë elemente të fantazisë nxisin aftësitë në të nxënë, funksionet ekzekutive dhe aftësitë vëtrregulluese të fëmijës.
- Loja pretenduese ndikon gjithashtu në motivimin e fëmijëve.
- Loja pretenduese e lejon fëmijën të jetë kreativ, të eksplorojë dhe zhvillojë ide dhe role të reja. Gjatë lojës dramatike, fëmijët janë në gjendje të vendosen në role të ndryshme si princesh, doktor, kësulkuqja, ujku etj dhe të aktrojnë në këto role sikur të jenë real (Gray, 2017).

Loja konstruktive . Loja konstruktive (ndërtuese) është e organizuar dhe orientuar drejt objektivave. Ajo haset më shpesh te fëmijët në moshën e çerdhës dhe ka të bëjë më shumë me praktikën (Drew, Christie, Johnston, Meckley & Neil, 2008)¹². Fëmijët përdorin lojën konstruktive kur ndërtojnë me kuba, lego.

- Loja konstruktive nxit imagjinatën e fëmijës pasi gjatë saj ata duhet të mendojnë çfarë duhet të krijojnë dhe ata i përdorin formueset në mënyra të ndryshme për të krijuar objektin që dëshirojnë (Gray, 2017; Drew. et al., 2008).

Loja me rregulla. Kur fëmijët përfshihen në një lojë me rregulla ata bien dakort t'i ndjekin këto rregulla midis tyre (Gray, 2017). Ndjekja e rregullave gjatë lojës mund të jetë e vështirë kjo pasi fëmijët janë egocentrik, dhe mendojnë se çdo gjë rrotullohet rreth tyre.

- Gjatë lojës me rregulla fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë dhe të mbajnë rradhë. Këto lojra u mësojnë fëmijëve të ndjekin rregullat dhe të kuptojnë se jo të gjithë mund të fitojnë.
- Të mësuarit e rregullave gjatë një moshe më të vogël është e rëndësishme për fëmijët pasi në një fazë tranzicioni nga çerdhja për në kopsht ose shkollë ata do u duhet të përballen me një

12 *Constructive Play: A Value- Added Strategy for Meeting Early Learning Standards.*

nivel tjetër, ku mësuesja do tu kërkojë të ndjekin rregullat e klasës ose grupit.

Loja sociale. Çdo lojë është konsideruar sociale nëse dy ose më shumë fëmijë ndërveprojnë me njëri-tjetrin (Gray, 2017). Gjatë kësaj loje fëmijës i duhet të komunikoj, madje shumë, të krijojë marrëveshje me të tjerët, të njohë nevojat e të tjerëve dhe të ndërveprojë me mësuesit dhe fëmijët e grupit. Loja sociale fillon të shfaqet rreth moshës 24 muajshe po ajo bëhet më e qëndrueshme dhe sofistikohet midis moshës 3- 6 vjeç. Gjatë moshës parashkollore loja sociale është ajo që merr pjesën më të madhe të kohës së fëmijëve. Kur fëmija luan ose merr pjesë në aktivitetet e një grupi atëherë ndodhë ndërveprimi. Është e rëndësishme për edukatorët ti lejojnë fëmijët të ndërveprojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin pa i ndërperë. Në këtë mënyrë fëmijët zbulojnë të drejtën nga e gabuara dhe si të krijojnë dhe ndërtojnë mardhëniet.



Loja mund të kategorizohet dhe nga mënyra se si fëmijët bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Sipas Mildred Parten's (1932)¹³ në një studim rreth ndërveprimit të fëmijëve gjatë lojës në klasë, ai gjeti se egzistojnë 6 faza të lojës. Këto faza përcaktoheshin nga zhvillimi dhe moshja e fëmijës. Stadi vijojnë nga lindja deri në moshën 6 vjeç.

Loja pasive (0-2) vjeç; Gjatë kësaj faze të lojës fëmija zakonisht është në pozicionin vëzhgues dhe përfshihet në lëvizje në dukje rastësore pa ndonjë objektiv. Ai vëzhgon në mënyrë strikte çfarë ndodhë përreth. Fëmija nuk bashkëvepron me askënd dhe asgjë. Për sa kohë që fëmija përfshihet në këtë lojë ai eksploron mjedisin rrethues përmes vëzhgimit, lëvizjes, tingujve (gugatjeve) dhe kapjes. Kur fëmija përfshihet në lojën pasive ai po përgatit veten për të kaluar në një hap më tej, drejt lojës vetmimtare (fëmija lëviz, eksploron pa ndonjë objektiv).

Loja vetmimtare; Loja vetmimtare ndodhë zakonisht rreth moshës 24- 36 muajshe. Gjatë lojës vetmimtare fëmija përfshihet në lojë i vetëm. I vetmi ndërveprim që ndodhë është midis lodrës dhe objektit me të cilin fëmija po luan. Fëmija nuk ndërvepron dhe as komunikon me personat e tjerë përreth. Fëmijët përfshihen në lojën vetmimtare për shkak të egocentrizmit që i karakterizon në këtë moshë dhe mungesës së aftësive gjuhësore.

Loja vëzhguese; Ndodhë zakonisht midis moshë 2.5- 3.5 vjeç por mund të haste edhe te fëmijët më të vegjël. Gjatë këtij stadi fëmija vëzhgon lojën e fëmijëve të tjerë por nuk bashkëvepron me ta. Fëmija që vëzhgon është kurioz rreth asaj çfarë po bëjnë fëmijët e tjerë, dhe në disa raste mund të pyes se çfarë ai mund të bëj, por nuk do të marrë pjesë në lojë. Vëzhguesi do vazhdoj të luaj i vetëm derisa të ndihet gati për tu përfshirë në lojë me të tjerët (fëmija vëzhgon dhe pyet rreth lojës së të tjerëve, por nuk përfshihet në të).

Loja paralele; Gjithashtu edhe kjo lojë shfaqet midis moshës 2.5- 3.5 vjeç. Kjo faze shënon kalimin nga loja vetëm në përfshirjen në lojë me të tjerët. Gjatë kësaj faze fëmija jo vetëm është vëzhgues, por ai luan nga ana tjetër edhe pse vetëm. Gjatë kësaj loje fëmijët janë pozicionuar pas njëri-tjetrit por secili ka lodrat e tij. Fëmijët nuk i ndajnë lodrat me njëri-tjetrin dhe janë zakonisht në botën e tyre të vogël.

13 *Social participation among preschool children. The Journal of Abnormal and Social Psychology, 27(3), 243-269*

Loja shoqëruese; Kjo formë e lojë priret të ndodhë rreth moshës 3-4 vjeç. Gjatë këtij stadi fëmijët fillojnë të shfaqin interes ndaj asaj çfarë po bëjnë dhe asaj që po luajnë së bashku. Zakonisht ata imitojnë njëri-tjetrin, kështu psh. Nëse një fëmijë do luaj “sikur po gatuan” edhe fëmija tjetër do marrë po objekte të ngjashme dhe do bëjë sikur gatuan. Mund të ketë edhe komunikim midis fëmijëve, por ata në përgjithësi po luajnë sërisht vetëm (fëmijët luajnë me blloqe krahe njëri- tjetrit, mund të ketë diskutime të vogla dhe ndërtojnë të njëjtën kullë).

Loja bashkëpunuese; Në moshën 4-6 vjeç, sapo fëmija bëhet më kurioz dhe i interesuar rreth asaj çfarë tjetri po bën, ata fillojnë të luajnë së bashku. Gjatë kësaj faze fëmijët fillojnë të ndajnë lodrat, të ndajnë dëshirat e tyre, nevojat dhe idetë me njëri-tjetrin, dhe të krijojnë së bashku. Në këtë faze fillon vërtet të krijohen mardhëniet pasi fëmijët bashkëveprojnë dhe të bien dakort me njëri- tjetrin në disa gjëra. Gjithashtu në këtë moshë fëmijët fillojnë të jenë më të kujdesshëm rreth emocioneve të veta dhe të të tjerëve.

4. Loja dhe zhvillimi: (Fëmijët rriten dhe qasja e tyre ndaj botës ndryshon).

Mosha mesatare	Karakteristikat e zhvillimit të fëmijës;
0 – 6 muajshe	<ul style="list-style-type: none"> Rrotullon kokën dhe duart duke ndjekur muzikën ose lëvizjet. I pëlqejnë lodrat lëvizëse. Zhvillon kontrollin e kokës. Kthen kokën në drejtimin e zhurmave ose lëvizjeve. Qëndron ulur. Fëmija zhvillon ndjenjat e sigurisë dhe besimit nëse i ofrohen metoda të rregullta. Fëmijës i pëlqen të shohë fytyra dhe fillon të përdorë shprehjet e fytyrës. I pëlqejnë tingujt qetësues. Reagon ndaj zhurmave dhe lëvizjeve që sheh. Reagon ndaj tingujve të rinj dhe lëvizjeve.
6 – 18 muajshe	<ul style="list-style-type: none"> Eksploron duke përdorur gojën. Është i interesuar për ambientin dhe eksploron atë. Krijon tinguj duke përplasur objekte. Mund të ulet pa ndihmë. Mund të qëndrojë në këmbë dhe të lëviz përreth mobiljeve. Ka lëvizshmëri të pavarur. Fëmija fillon të njohë vetveten si një person i veçantë. Fillon të dallojë që disa veprime prodhojnë pasoja. I pëlqejnë vjershat e përsëritura si dhe të parashikojë veprimet. Fëmija fillon të belbëzojë. Arrin të imitojë tinguj dhe gjeste. Shpesh lëshon tinguj edhe vetë. Nxit veprimet e të tjerëve. I përsërit ato edhe vetë, p.sh. ushqen arushin. Preferon ti zgjedhë vet aktivitetet dhe mund të përfshihet totalisht në to. Mund të ketë vështirësi në ndjekjen e aktiviteteve të udhëhequra nga të rriturit.
18 muajshe -3 vjeçare	<ul style="list-style-type: none"> Mund të luajë lojën “Tah”. I pëlqejnë lodrat me shkak dhe pasojë. Fillon të njohë sendet që janë të njëjta dhe t’i klasifikojë ato. I pëlqen të luajë me rërë dhe ujë. Preferon të luajë përjashta ose në dysheme. Loja paralele. Do të luajë përkrah fëmijëve të tjerë. Mund të fillojë lojën me të rriturit duke i çuar atij ndonjë lodër. Mund të drejtohet tek aktivitetet që organizohen nga një i rritur dhe të marrë pjesë në to.

<p>3 – 4 vjeçare</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkohet në recitime vjershash dhe këngë lëvizore. I pëlqen përsëritja e përrallave. Di të thotë emrat e figurave dhe të nxjerrë tinguj duke imituar, p.sh. kafshët. Mund të flasë për veprimet. • Përdor arushat dhe kukullat për të realizuar disa veprime. Janë të dukshme në lojë sendet “simuluese”, p.sh. përgatitja e çajit dhe filxhani për të pirë duke përdorur filxhan lodre. • Është i aftë të ndjekë aktivitete të udhëhequra nga të rriturit. Ka nevojë për prezencën e të rriturve për të ruajtur përqendrimin. Fokusetohet në një aspekt të vetëm gjatë një kohe të caktuar dhe mund të përfshihet totalisht. Ndryshimi i objektit të vëmendjes mund të kërkojë ndihmën e një të rrituri. • I pëlqejnë aspektet krijuese p.sh. gatimi, • Mund të bëjë figura me copa. • Lojë aktive – i pëlqejnë shkallët dhe pajisjet si dhe lodrat me pedale, që shtyhen. • Bashkohet me grupin. Merr iniciativën të krijojë kontakte me fëmijët e tjerë dhe luan me të tjerët. • Di fjalët e këgëve dhe vjershave dhe mund të këndojë pa ndihmë. Mund të bisedojë për një objekt apo ngjarje edhe nëse nuk ndodhet atje. • Mund të përdorë lodra dhe sende për të vënë në skenë ngjarje të ndodhura gjatë kohëve të fundit. Përfshihet totalisht në lojën imituese siç është këndi i shtëpisë, bërja e pazarit etj. • Nuk shpërqendrohet më aq lehtësisht ndaj detyrave të drejtuara nga të rriturit. Mund ta zhvendosë vëmendjen nga një aktivitet në tjetrin. Ka nevojë të ndalojë aktivitetin për të dëgjuar udhëzimet.
-----------------------------	---

5. Rëndësia e lojës dhe ndikimi i saj në zhvillim.

Loja është shumë e rëndësishme në stimulimin e zhvillimit të fëmijëve pasi ajo ndikon në mirqënien fizike, kognitive, emocionale dhe sociale të fëmijëve dhe të të rinjve. Gjithashtu loja u jep mundësi prindërve tu kushtojnë kohë cilësore dhe të angazhohen plotësisht me fëmijët e tyre. Pavarsisht të mirave që ka loja si për prindërit dhe fëmijët, në ditët e sotme koha që kalojnë fëmijët në lojën e lirë është e reduktuar. Fëmijët sot marrin më pak mbështetje për të luajtur në mjedise të hapura krahasuar me gjeneratat e kaluara, kjo pjesërisht për shkak të një stili jetese më të shpejtë, ndryshimeve në strukturën e familjes, i kushtohet më shumë vëmendje arritjeve akademike dhe zhvillimin e aftësive edukative të fëmijës duke reduktuar angazhimin në lojën e lirë. Por cilat janë të mirat e përfshirjes së fëmijëve në lojë?

“Sipas terapistit të lojës O. Fred Donaldson,” Një fëmijë i cili është lejuar të luaj ka shumë avantazhe më vonë. Ai zhvillonë aftësi gjuhësore universale. Loja zhvillon aftësitë kreative dhe imagjinatën. Loja prodhon gëzim i cili është shumë i rëndësishëm për vetëvlerësimin dhe shëndetin e fëmijës.”

Fëmijët përfitojnë më shumë nga loja kur ajo është e larmishme, mund të ndodhë që fëmija të luajë vetëm e më pas me shokët, të luajë jashtë, në tavolinë apo në dysheme. **Studimet kanë treguar se loja në tapet ka po aq benefite sa loja në natyrë.** I rrituri mund të ndërhyjë në lojën e fëmijëve duke

i siguruar hapësirën dhe mjetet e nevojshme për të luajtur, kjo do të zgjaste në kohë interesin e fëmijës për lojën.



Zhvillimi kognitiv dhe gjuhësor. (Të flasësh, të mendosh, të krijosh.)

Loja ndihmon në zhvillimin e bazave të gjuhës, pasi nivelet e mëvonshme të të nxënit ndërtohen mbi ato fillestare. Elementë të tillë si spontaniteti, të menduarit, kreativiteti, imagjinata dhe besimi zhvillohen më së miri përmes lojës gjatë fëmijërisë së hershme. Fuqia e lojës është pikërisht të sigurojë vetë-vlerësim dhe mardhënie ndërpersonale.

Studiues nga vende të ndryshme kanë treguar se ka një marrëdhënie të rëndësishme midis aftësive të hershme të lojës sociale dhe zhvillimit të aftësive të mëvonshme në komunikim. Gjithashtu reagimi i kujdestarit primar dhe mënyra se si manipulon lojën fillestare të fëmijës do të ndikojë në zhvillimin e gjuhës te fëmija në moshën 14 muajshe. Proceset kognitive që përfshihen gjatë lojës janë të ngjashme me ato që aktivizohen gjatë të nxënit, si: motivimi, të kuptuarit, përsëritja, vetë-rregullimi dhe të menduarit abstrakt. Vëmendja gjatë lojës lidhet ngushtë me llojin dhe numrin e lodrave të pranishme. (Mayer 1955)¹⁴. Loja eksploruese dhe e lire ndikon dhe nxit të mësuarit (Shulc 2008)¹⁵. Aftësitë për të lexuar, folur dhe ato matematikore formohen në bazë të aftësive të fëmijës për të përdorur objektet në mënyrë simbolike (psh: fëmijët përdorin legot për të përfaqësuar një gotë). Loja që fëmija zhvillon në moshën 13-24 muajshe ndikon në zhvillimin gjuhësor të tij në një moshë më të rritur (Hall 1991, Ungre 1986)¹⁶.

Ndërkohë që forma të ndryshme të lojës me sikur çojnë në arritjen e rezultateve të larta në shkollë, nxisin aftësitë sociale dhe kreativitetin. Ekspozimi i hershëm i fëmijës me lojën, veçanërisht me atë të pretenduar në çerdhe, ndikon në nxitjen e aftësive të fëmijës më vonë në kopsht (Katz 2001, Roshos 2007 dhe Singes 2002). Loja dhe lodrat ndikojnë gjithashtu në zhvillimin e të kuptuarit abstrakt dhe rastësor, pasi gjatë lojës objektet vendosen në nivele të ndryshme abstraksioni. Kërkuesit, edukatorët dhe prindërit besojnë se fëmijët mësojnë më shumë nga marrëdhëniet dhe situatat e krijuara gjatë lojës eksploruese.

“Për të mësuar në një mjedis formal, fëmijët duhet të jenë të aftë të rregullojnë sjelljet e tyre, emocionet dhe komunikimin, dhe të përfshihen në marrëdhënie me të tjerët në mënyrë të përshtatshme” (Fisher 2011)¹⁷.

Kërkuesit theksojnë qartë lidhjen midis eksperiencave të mësuara përmes lojës dhe aftësive sociale, vetë-rregulluese dhe atyre akademike. Kur Fisher flet për të "mësuarin përmes lojës" i referohet lojës së lirë dhe jo lojës së orientuar nga të rriturit me qëllim zhvillimin e aftësive akademike dhe sociale.

Një rishikim i 40 studimeve gjeti se loja ndikon në zgjidhjen e problemeve, sjelljeve bashkëpunuese, të menduarit logjik si dhe nivelin e IQ. Personat të cilët angazhohen në lojë gjatë fëmijërisë kanë tendencë të jenë më social ndaj bashkëmohatarëve të tyre. Loja ndikon në ecurinë e zhvillimit nga 33%- 67% duke rritur aftësitë vetrregulluese, nxitur gjuhën dhe duke ulur vështirësitë emocionale (Fisher 1992)¹⁸.

14 Moyer, K.E., von Haller Gilmer, B. (1955). "Attention Span of Children for Experimentally".

15 Schulz, Laura E., S, H. R., and Bonaëitz, E. B. (2008).

16 Hall, N. (1991). *Play and the emergence of literacy*. Ungerer, J. A., and Sigman, M. (1986).

17 Fisher, K., Hirsh-Pasek, K., Golinkoff, R. M., Singer, D. G., and Berk, L. (2011). "Playing around in school: Implications for learning and educational policy."

18 Fisher, E. P. (1992). *The impact of play on development: A meta-analysis*. *Play and Culture*, 5, 159-181.

Ndikimi i lojës në gjendjen emocionale



- Loja redukton frikën, ankthin, stresin dhe zemërimin.
- Krijon lumturi, vetëvlerësim dhe ndihmon në procesin e rritjes.
- Nxiti fleksibilitetin emocional dhe praktikitetin.
- Rrit qetësinë, resilencën, aftësinë për tu përshatur dhe përballur me situata të paparitura.
- Loja shërben si një shkarkues emocional.

Benefitet sociale të lojës

- Rrit ndjenjën e empatisë, mëshirës dhe ndarjes.
- Krijon mundësi dhe zgjedhje.
- Modelon marrëdhënien e bazuar në përfshirje dhe integrim.
- Nxiti aftësitë joverbale.
- Rrit atashimin dhe vëmendjen.

Benefitet fizike.



- Emocionet pozitive rrisin efikasitetin e sistemit kardiovaskular.
- Ul nivelet e stresit, lodhjes, dhimbjes dhe depresionit.
- Ndikon në rritjen e koordinimit, ekulibrit, fleksibilitetin dhe në motorikën fine dhe globale.



Studimet e shumta kanë arritur në përfundim se loja mundëson që fëmija:

- Të kuptojë botën që e rrethon.
- Të zgjerojë të kuptuarin social dhe kulturor.
- Të shprehë mendimet dhe ndjenjat e tij.
- Të praktikojë të menduarin fleksibël dhe divergjent.
- Të ballafaqohet dhe zgjidhë problemet reale.
- Të mësojë të marrë në konsiderate perspektivën e të tjerëve.
- Të zhvillojë vetë-kontrollin.
- Të rritë aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore.
- Ndihmon në zhvillimin e trurit dhe zhvillimin motorik.

Si biolog zhvillimi J. Piaget ka thënë, “Mund të jemi të sigurt se gjithcka e këndshme ose e pakëndshme që ndodh në jetën e fëmijës, do të rishfaqet te kukulla e tij.”(Piaget 1962)¹⁹.

¹⁹Piaget, Jean. (1962). *Play, dreams, and imitation in childhood*.

6. Loja në natyrë, kalimi nga ekranet në lojën e vërtetë.

“Ndoshta, më shumë se sa të jenë të zgjuar dhe të bashkëveprojnë me të tjerët, prindërit duan që fëmijët e tyre të jenë të lumtur.... (Burdette 2005)²⁰.



Ndryshimet në shoqërin modern normalisht kanë ndikimin e tyre dhe në eksperiencat e fëmijëve. Me zhvillimin e teknologjisë, rritjes së cilësisë së jetesës, urbanizimit dhe zhvillimit të qyteteve edhe mënyrat se si fëmijët kalojnë kohën e lire kanë ndryshuar. Koha që fëmijët kalojnë në natyrë është reduktuar, duke ia lënë vendin jetesës sedentare. Si një aktivitet sa natyral dhe ftues loja ndikon në mirqënien kognitive, emocionale, sociale dhe fizike duke ofruar kështu kushtet e rëndësishme për tu rritur dhe mësuar. Përmes lojës fëmija mund të "eksperimentoj" zgjidhjen e problemeve, të mendojë në mënyrë kreative, të bashkëveprojë me të tjerët etj... fiton njohuri për veten dhe botën që e rrethon. Që në moshë të vogël fëmijët përmes lojës së pastrukturuar në të cilën është ai që vendos çfarë të bëjë dhe me kë të luaj, promovon vetëvlerësim pozitiv, autonomi dhe vetë- konfidencë.

Mjediset e jashtëme konsiderohen si vende të hapura dhe që ndryshojnë vazhdimisht ku është e mundur ndihemi të lirë, të zhvillojmë aftësitë fizike pasi mund të vrapojmë, hidhemi dhe të jemi në kontakt me elementët e natyrës. Duke luajtur në mjedise jashtë banesës fëmijët përfitojnë prej rrezeve të diellit, elementëve të natyrës dhe ajrit të pastër të cilët kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e mushkrive, rritjen e imunitetit dhe në aktivitetin fizik. Nëvoja për tu marrë më shpesh me aktivitet fizik që në moshë të hershme lidhet shumë me jetën gjithnjë e më shumë sedentare si dhe me rritjen e obezitetit dhe mbipeshës. Gjithashtu, loja në natyrë ndikon në rritjen e përqëndrimit dhe mirëqënies së fëmijëve. Edhe pse evidencat dhe kërkimet rreth rëndësisë së të qëndruarit në ambjente të hapura janë rritur duket se këto nuk kanë ndikim të madh në ndryshimin e eksperiencave dhe mjediseve ndaj të cilave fëmijët kanë akses. Ndryshe nga ajo çfarë është pritur, mundësia për të patur parqe ose mjedise të hapura është ulur si pasojë e globalizimit, teknologjisë dhe zhvillimit urban.

Çfarë i pengon prindërit dhe edukatorët ti ekspozojnë fëmijët e tyre ndaj mjediseve natyrore?

- **Frika ndaj aksidenteve** të mundshme mund të ketë ndikimin e saj në qasjen e të rriturve ndaj lojës në mjedise të hapura, kështu që fëmijët tentojnë të qëndrojnë të mbyllur, duke luajtur në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar nga të rriturit. Sipas Gill këto frikëra lidhen me një keqinterpretim të realitetit, pa patur zakonisht një ndikim të qenësishëm në shoqëri.
- Një arsye tjetër lidhet me faktin se **shumica e prindërve punojnë gjatë pjesës më të madhe të ditës** dhe tentojnë ti regjistrojnë fëmijët e tyre në kurse apo qendra edukimi në mënyrë që të rrisin më tej njohurit dhe aftësitë e tyre. Në këtë mënyrë kohës gjatë të cilës fëmijët luanin të lire ia kanë zënë vendin aktivitete sportive dhe akademike. Për të shkuar nga një aktivitet në tjetrin fëmijët tashmë përdorin makinat duke evituar ecjen në rrugë ose mjedise të jashtme.
- Studime të ndryshme kanë vënë re se gjatë periudhës së dimrit fëmijët tentojnë më pak të luajnë jashtë, kjo për shkakë të **frikës së mos sëmurën ose ftohen**. Fëmijët sot frekuentojnë më shumë mjediset e mbyllura si supermarketet, këndet e lojrave në mjedise të mbyllura,

²⁰Burdette, *Resurrecting free play in young children looking beyond fitness and fatness to attention, affiliation, and affect. Archives of Paediatrics and Adolescent Medicine, 159, 46-50.*

kopsht, çerdhe ku ekspozimi ndaj sëmundjeve dhe ajrit të ndenjtur është më i lartë. Kështu nëse mendoni se duke evituar mjediset e hapura fëmija juaj do të sëmuret më rrallë, ky është një mendim i gabuar, ka më shumë gjasa që fëmijët të sëmuren kur qëndrojnë në ambjente të mbyllura kjo pasi hapsira fizike është më e vogël dhe kontakti me fëmijë të tjetër të sëmurë është më i lartë. **Një fëmijë duhet të luaj të paktën 40 minuta në ditë në natyrë, parqe të hapura lojrash në mënyrë që të përfitojë nga të mirat që ofron ky lloj aktiviteti.**

Çfarë përfitojnë fëmijët nga loja në mjedise të hapura.



" Çdo fëmije duhet ti jepet mundësia të luajë në natyrë.

Koha optimale që një fëmijë duhet të luaj në mjedise të hapura është të paktën 40 min në ditë."

Gjatë lojës në mjedise të hapura fëmijët kanë mundësi të jenë në kontakt me elementë të ndryshëm të natyrës. Mjedisi i jashtëm ofron shumë stimuj që tërheqin vëmendjen dhe interesin e fëmijëve. Shkopinj, gurë, lulet, gjethet, dheu, bari eksplorohe me kuriozitet nga fëmija dhe nxisin të mësuarin për sa kohë fëmija i përdor ato për të luajtur. Elementët e natyrës u përgjigjen nevojave dhe imagjinatës së fëmijëve, në këtë mënyrë ata mund tu japin objekteve kuptime të reja dhe të ndryshme në të njëjtën kohë psh një shkop mund të përdoret si një varkë, një gjethe si pjatë etj. Kjo do çojë më vonë në zhvillimin e aftësive kreative, në zgjidhjen e problemeve, dhe bashkëveprimin me të tjerë. Mbi të gjitha ju nuk duhet të shpenzoni për këto objekte, pasi ato gjenden kudo në natyrë dhe nuk kanë limitet që kanë objektet komerciale. Eksplorimi i elementëve të natyrës është gjithashtu i rëndësishëm për të tërhequr vëmendjen e fëmijëve ndaj pasurive dhe diversitetit natyror. Ndjenja e eksplorimit dhe magjepsja ndikojnë në procesin e të mësuarit dhe nxisin zhvillimin e lidhjeve emocionale përkundrejt mjedisit. Përmes lojës në mjedise të hapura dhe eksplorimit të elementëve të natyrës, do të jetë e mundur të promovojmë edukimin në kuptimin e plotë të fjalës. Kështu aktivitetet me ujë, dhe' mund të jenë një mundësi për të përvetësuar konceptet matematikore, të fizikës dhe gjuhës. Kur fëmijët luajnë me një sërë elementësh atyre do tu duhet të shpjegojnë se çfarë po bëjnë, do pyesin rreth elementëve të panjohur për ta dhe kështu një fjalor i ri do të përvetësohet. Kontakti me ujin ose dheun sipas kërkuesve ka një impakt pozitiv në rritjen e imunitetit të fëmijëve. Kërkuesit e zhvillimit kanë treguar rreth rëndësisë së eksperiencave që promovojnë kontaktin me ato që quhen "mikrobe të padëmshme", që na lejojnë të jemi të mbrojtur përball virozave.



Rëndësia e rrezikut;

" Gjërat e mëdha asnjëherë nuk vinë nga zona e komfortit " (B. Francia)

Shoqëria e sotme pothuajse e ka neglizhuar rëndësin e "rrezikut" në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Një kulturë frike na bënë ne të nënvlerësojmë atë çfarë fëmijët janë vërtet të zotë të arrijnë, duke krijuar kështu mjedisin më të "pasigurt" për ta, në të cilin fëmijët nuk do të kenë mundësinë të mësojnë se si të jenë të sigurt. Është e rëndësishme të adoptojmë një vision tjetër të rrishtit, përtej aksidenteve duke konsideruar dhe elementët pozitiv që lidhen me ndjenjën e suksesit dhe lumturisë pasi një aftësi e re është arritur. Në mjedisin e jashtëm fëmija ka mundësi të testojë limitet e veta duke u përfshirë në situata të tilla si të ngjisë një pemë etj. Gjithashtu në situata të tilla

shohim ndonjëher që fëmijët arrijnë të gjejnë vetë zgjidhjen e problemeve që hasin në një mjedis të hapur. Gjatë lojës në natyrë i rrituri mund të qëndrojë në distancë dhe të vëzhgojë fëmijën duke e lënë të lirë të eksplorojë mjedisin përreth. Si të rritur duhet tu sigurojmë fëmijëve mjetet dhe hapsirën e nevojshme. Loja në mjedise me një rrezikshmëri të konsiderueshme i jep mundësi fëmijës të zhvillojë një sër aftësishë si në zgjidhjen e problemeve, vetë- besim, këmbëngulje, vetë-angazhim dhe të njohë më mirë veten. Gjatë lojës fëmija duhet ti jepet mundësia të dështojë ose të ketë sukses duke mësuar nga gabimet dhe arritjet. Nëse ne do të parandalojmë të gjitha situata e rrezikshme atëher fëmijët në një moshë më të rritur nuk do dinë si të reagojnë në situata të paparashikuara dhe do kenë më pak konfidenc në përballjen e tyre në mënyrë të pavarur. Mjedisi i jashtëm na ofron shumë mundësi që fëmijët të tregojnë cilësi të personalitetit të tyre dhe aftësi të cilat nuk shfaqen në mjediset e brendshme.

Maynard, Waters dhe Clement²¹ zbuluan se lojrat në mjedise të hapura u ofrojnë më shumë dije fëmijëve duke e bërë edhe më të lehtë procesin e edukimit. Gjithashtu, fëmijët kanë më pak gjasa të konfliktohen, të vriten me njëri- tjetrin kur luajnë jashtë se sa kur ndodhen në një dhomë. Frekuentimi i haspsirave të hapura u lejon fëmijëve të kenë më shumë mundësi dhe hapsirë fizike, çfarë u lejon atyre të vendosin më shumë objektiva dhe të bashkëpunojnë me njëri- tjetrin për ti arritur ato. Gjatë lojës jashtë fëmijët behen mësues dhe nxënës duke ndarë dijet dhe mendimet e tyre rreth asaj që shohin përreth. Gjatë lojës në mjedise të hapura procesi i socializimit ndodhë në mënyrë graduale duke i dhënë mundësinë fëmijës të zgjedhë të luaj me fëmijët e tjerë ose të vazhdojë të luaj i vetëm, pa qënë e nevojshme të vrapojnë pas njëri-tjetrit siç ndodh në dhomën e lojës.

7. Roli i prindit në lojën e fëmijës.

Prindërit kanë një ndikim të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, e megjithatë kur flasim për lojën, roli i prindit është disi më pasiv. Nuk duhet të harrojmë që loja është një aktivitet i krijuar dhe që u përket vetëm fëmijëve, kështu që janë vetëm ata të cilët do na drejtojnë në lojën e tyre. E megjithatë të rriturit duke patur më shumë njohuri rreth zhvillimit dhe mënyrës se si fëmijët luajnë mund të përfshihen në lojë për ti mësuar atyre disa aftësi më shumë. Nëse doni që të përfshiheni në lojën e fëmijës suaj duhet të keni në konsiderat dy gjëra.

1. Fëmija juaj duhet t'ju lejohet të luajë në natyrë. Çka do të thotë që është fëmija juaj që ju fton të luani me të dhe hyrja juaj në lojë nuk duhet të bëhet në mënyrë intruzive.

2. Rregullat dhe rolin tuaj në lojën e fëmijës e përcakton vetë ai. I rrituri në lojën e fëmijës duhet të qëndrojë në një rol pasiv dhe të presë që fëmija ti tregojë atij se çfarë duhet të bëjë.

Ajo çfarë mund të bëni për ti dhënë mundësi fëmijës të luaj është që të:

- Siguroheni që fëmija juaj të ketë hapsirën e nevojshme për të zhvilluar lojën e tij. Fëmija mund të luaj në sallon, në dhomën e tij ose në oborrin e shtëpisë.
- Sigurohuni që mjedisi ku fëmija juaj luan të jetë i sigurt dhe përreth tij të mos ketë mjete të rrezikshme që mund të çenojnë mirqëniën e tij fizike.
- Ofrojini fëmijës një shumëllojshmëri objektesh dhe lojrash si pazëlla, kuba, lego, kukulla,

²¹ Maynard T, Waters J, Clement J. "Moving outdoors: further explorations of "child-initiated" learning in the outdoor environment. *Education*" 3-13. 2013; 41:282-99.

makina etj. Sa më shumë lodra që fëmija të ketë aq më e larmishme do jetë loja e tij dhe interesi i tij ndaj lojës do jetë edhe më i madh.

- Nxirreni fëmijën shpesh gjatë javës në parqe lojrash të hapura ose në mjedise natyrore. Vëzhgojeni fëmijën kur luan në këto mjedise, por mos ndërhyri shumë në lojën e tij. Mos harroni që koha optimale që një fëmijë duhet të luaj në natyrë është 40 min në ditë.
- Evitoni përdorimin e mjeteve teknologjike si telefonë, televizorë, ajo çfarë fëmija mund të përfitojë nga loja është shumë më shumë se sa ajo çfarë ofron teknologjia. Shpesh në takime prindër dëgjojnë shumë prindër që thonë se nuk kanë zgjidhje tjetër pasi fëmija qan. Qëndroni pranë fëmijës suaj në këto momente dhe mundohuni të krijoni situata dhe lojra që të tërheqin vëmendjen e tyre.

8. Disa aktivitete që mund të zhvilloni me fëmijën tuaj;

Për fëmijët 0- 1 vjeç ju mund të zhvilloni disa aktivitete në kushtet e shtëpisë, çerdhes në mënyrë që t'u mësoni atyre disa aftësi.

Aktiviteti 1

Foshnja ulet dhe shikon

Mjetet e nevojshme

Mjedise të rehatshme, brenda ose jashtë shtëpisë, të cilat japin mundësi për të parë një numër të madh aktivitetsh.

Udhëzimet

Uluni me fëmijën në një vend të rehatshëm dhe sigurohuni që fëmija të jetë përballë jush. Tregoni me gisht objektet dhe gjërat që po ndodhin përreth (lodrat e fëmijës, makinat, zogjtë që këndojnë, shiun që bie, figurat në libra etj) dhe përshkruani me fjalë gjithçka që po i tregoni. Vini re se si fëmija juaj hidhet dhe përpiqet të kapë atë që ju i tregoni.

Përfitimet

Kjo ndihmon fëmijën në forcimin e gjymtyrëve p.sh ndihmon që fëmija të ulet pa ndihmë. Kur fëmija juaj të jetë në gjendje të qëndroj ulur vetë mos e mbani në prehër, por uleni në dysheme dhe zhvilloni të njëjtin aktivitet. Ky aktivitet e ndihmon fëmijën të zhvillojë lëvizjet bazike të trupit si, zgjatja e duarve, kokës, hedhja, kontaktin me sy, ndjekjen e objekteve, forcimin e gjymtyrëve.

Aktiviteti 2

Imitimi i tingujve

Në moshën 6 muajshe foshnjët fillojnë të thonë fjalët e para dhe përdorimi i tingujve karakterizon gjuhën e tyre.

Për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të fëmijës ju mund të zhvilloni lojëra me fëmijën tuaj duke imituar tinguj të ndryshëm si tingujt e kafshëve si: “*mu*”, “*be*”, “*hum*” etj, objekteve si: tingulli i makinës, motorrit etj.

Gjatë imitimit të tingujve ju mund t’i tregoni fëmijës dhe objektet ose figura që përkojnë me tingullin përkatës. Gjatë këtij aktiviteti mund të përdorni dhe lodra me muzikë.

Përfitimet

Nëpërmjet këtij aktiviteti fëmija zhvillon aftësitë gjuhësore dhe imituese.

Aktiviteti 3

Aktivitete ndijore

Lojrat ndijore janë shumë të rëndësishme për të zhvilluar aftësitë sensorë të fëmijët 6 muajsh deri në 1 vjeç. Lojra të tilla ndihmojnë fëmijët të njohin dhe dallojnë objektet nga njëri-tjetri dhe përbërjet e tyre. Në kushtet e shtëpisë mund të përdorni mjete të tilla si gurë, dhe’, ujë, oriz, miell etj. Vendosini këto objekte në një tas ose një objekt të përshtatshëm dhe nxitini fëmijët t’i prekin ato dhe të luajnë. Këndi i rërës dhe ujit është gjithashtu një mjedis i përshtatshëm për të zhvilluar lojra të kësaj natyre.

Aktiviteti 4

Loja e pasqyrës

Faza e pasqyrës është shumë e rëndësishme në procesin e zhvillimit të fëmijës. Zakonisht fëmijët fillojnë të njohin imazhin e vetes në pasqyrë rreth moshës 8 muajshe.

Vendoseni fëmijën tuaj përballë një pasqyre e cila duhet të jetë në një madhësi të tillë që fëmija të shohë të tërë pasqyrimin e tij. Do të shikoni që fëmija fillimisht do të shikojë imazhin e vetes. Disa fëmijë mund të thonë “*bebi*” dhe të mos e kuptojnë që imazhi në pasqyrë është i tij, ai do të shikojë edhe nga ju, për të kërkuar miratim. Tregojini fëmijës që imazhi në pasqyrë është vetë ai. Te fëmijët me vështirësi në zhvillim ky proces është më i vështirë dhe formimi i imazhit të vetes mund të ndodhë në një moshë më të vonë.

Aktivite për fëmijët 1-3 vjeç

Aktiviteti 1

Loja “ Ta, Ta”

Uluni me fëmijën dhe luani lojën “ Ta- Ta” duke mbuluar fytyrën tuaj me duar. Sapo fëmijë të filloj të kuptoj lojën, inkurajojeni të ndjekë edhe ai lojën duke mbulur fytyrën e tij me duar. Vazhdoni duke u fshehur mbrapa objekteve si: pemë, tavolinë, perde etj, duke i thënë shpesh fëmijës “ta, ta”.

Me fëmijët më të mëdhenj, ju mund të zhvilloni lojën duke u fshehur si ju dhe fëmija juaj dhe më pas të gjeni njëri- tjetrin.

Përfitimet

Ky aktivitet e ndihmon fëmijën të zhvillojë aftësitë në koordinimin e duarve, për të ndjekur lëvizjet me sy dhe për t’u orientuar në hapsirë.

Aktiviteti 2

Koordinimi i duarve

Uluni me fëmijën tuaj dhe filloni të lexoni një libër me figura. Mund të jetë libri i preferuar i fëmijës suaj.

Tregoni figurat me gisht dhe diskutoni në lidhje me imazhet e paraqitura në libër. Kërkojini fëmijës ta kthej ai faqen e librit. Mos u shqetësoni nëse fëmija juaj kalon disa ose të gjitha faqet e librit përpara se ju t’i lexoni ato.

Kjo lojë mund të zhvillohet edhe duke shkëmbyer me njëri- tjetrin lodra të ndryshme.

Përfitimet

Ky aktivitet ndihmon fëmijën në zhvillimin e koordinimit sy- dorë si dhe motorikën fine.

Aktiviteti 3

Loja me top

Uluni në tapet përballë fëmijës duke i vendosur këmbët në formë ‘V’, ose në gjunjë nëse ky pozicion është më i rehatshëm për ju. Sigurohuni që fëmija juaj të jetë në po të njëjtin pozicion dhe përballë jush. Hidhni topin në drejtim të fëmijës në një distancë 1- 2 m dhe kërkonit që fëmija ta kthejë mbrapsht atë. Nëse fëmija është në gjendje të kapë dhe hedhë topin atëherë mund të luani më shpejt ose mund ta hidhni topin në ajër nëse ai arrin ta kapë atë.

Përfitimet

Ky aktivitet i ndihmon fëmijët të kontrollojë motorikën fine, forcon muskujt e duarve dhe zhvillon koordinimin sy- dorë.

Aktiviteti 4

Loja me " fluskat e sapunit"

Bëni disa fluska sapuni përballë fëmijës suaj dhe inkurajoheni atë ti kap ato. Nëse fëmija juaj po ecën ose vrapon sigurohuni që të mos ketë objekte të rrezikshme përreth.

Përfitimet

Ky aktivitet e ndihmon fëmijën të zhvillojë motorrikën fine/globale si dhe të ndjekë lëvizjet me sy dhe të orientohet në hapësirë.

Aktiviteti 5

Këngët lëvizore

Në programin e edukimit që zhvillohen në çerdhet publike të Bashkisë Tiranës, një pjesë të rëndësishme kanë dhe këngët lëvizore të cilat ju mund ti siguroni nga edukatorët e fëmijës suaj.

Përfitimet

Përmes këngëve lëvizore fëmija zhvillon aftësi fizike si hedhja, kërcimi. Zhvillon motorrikën fine dhe globale, zhvillon aftësi imituese dhe kryejnë në të njëjtën kohë disa lëvizje.

9. Loja dhe fëmijët me nevoja të veçanta:

Fëmijët me nevoja të veçanta përfshihen më rrallë në lojë krahasuar me fëmijët të cilët kanë një zhvillim tipik. Ata kanë nevojë për mbështetjen e specialistëve që të mësojnë përmes lojës. Shpesh na lind pyetja: "A luajnë fëmijët me nevoja të veçanta ndryshe nga fëmijët e tjerë? " Studime të ndryshme dhe analiza të specialistëve kanë treguar se fëmijët me nevoja të veçanta luajnë ndryshe nga fëmijët me zhvillim tipik. "Të gjithë fëmijët mund të luajnë"- thekson dr. Fred Donaldson- "Si një bashkëshoqërues në lojë unë e përshtas lojën në mënyrë që të gjithë të luajnë. Nuk është fëmija me nevoja të veçanta ose kultura me të cilat unë luaj."

Përfitimet që kanë fëmijët me nevoja të veçanta nga lojrat aktive janë të shumta. Lojrat aktive jo vetëm që ndikojnë në mirëqënien fizike të fëmijës, por gjithashtu ndikojnë në zhvillimin e tij mendor. Duke luajtur me fëmijën tuaj ju do të jeni në gjendje ti mësoni atij disa aftësi por duhet të dimë se ai ka nevojë për ndihmën tuaj gjatë lojës.

Disa lojra që ju mund të zhvilloni me fëmijët tuaj janë:

Lojrat ndijore.

Përdorni lodra me muzikë sidomos nëse fëmija juaj ndodhet midis moshës 6- 24 muajsh. Lojrat me muzikë tërheqin vëmendjen e fëmijëve dhe u japin atyre një sërë stimuluesh. Fluskat e sapunit është një lojë që fëmijëve u pëlqen shumë. Nxiteni fëmijën që ti kap ato. Përdorni lodra dhe objekte që janë përbërë nga materiale të ndryshme dhe ndihmoheni fëmijën që ti prek ato.

Te fëmijët të cilët kanë vështirësi fizike mund të organizoni aktivitete të tilla si: hedhja, kapërcimi i

objekteve, zbritja ose ngjitja e një shkalle etj. Fëmija duhet të stimulohet sa herë që ai zhvillon një aktivitet dhe ju duhet ta ndihmoni atë nëse kjo është e nevojshme deri sa ai të jetë në gjendje ta kryej veprimin i vetëm. Vraponi së bashku me fëmijën tuaj nëse ai preferon të vrapoj në shtëpi. Vëreni nëse ai po ju shikon kur ju zhvilloni këtë aktivitet.

Organizoni sa më shumë aktivitete me ujë, rërë, baltë etj. Stimuloni fëmijën të prek objektet në mjedisin e jashtëm si gjethet, barin, gurët etj. Gjatë aktiviteteve flitini fëmijës rreth objekteve që ata po eksplorojnë duke i emërtuar ato. Edhe pse do ju duket se fëmija nuk po ju ndjek dhe ndoshta nuk po ju kupton ju vazhdoni ta bëni këtë gjë. Zhvilloni gjithashtu lojra me top.

Këngët lëvizore, lojrat ritmike.

Fëmijët me nevoja të veçanta kanë një interes të veçantë ndaj këngëve dhe lojrave ritmike. Edhe pse ndonjëherë nuk ekzekutojnë si duhet lëvizjet ose duket se nuk përfshihen në aktivitete të tilla, këto aktivitete arrijnë të tërheqin vëmendjen tyre. Në momentin që ju zhvilloni këto lojra dhe shikoni se fëmija është i interesuar, ndihmoheni atë që të imitoj lëvizjet.

Zhvilloni lojra të tilla si: "roza- rozina" në mënyrë që fëmija të marrë pjesë në aktivitet së bashku me fëmijët e tjerë. Mos prisni që fëmija juaj të jetë ai që fillon lojën ose të përfshihet vet në lojë, ai ka nevojë gjithmonë për ndihmën tuaj që të përfshihet në një aktivitet. Përmes lojrave të tilla fëmija do të zhvillojë jo vetëm aftësit motore, por edhe ato sociale dhe imituese.

Një aktivitet interesant është të krijoni një ritëm të caktuar duke përplasur duart në tavolinë ose me njëra- tjetrin, vëreni nëse fëmija juaj shfaq ndonjë interes të veçantë ndaj këtij aktiviteti. Nëse po ndihmoheni që edhe ai të kryej të njëjtin aktivitet.

Lodrat

Pavarsisht se fëmijët me nevoja të veçanta nuk i përdorin lodrat në varësi të funksionit, ju mund t'i përdorni ato për t'i mësuar fëmijës disa aftësi. Kështu, mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të nxjerr dhe të fusë vetë lodrat në kosh. Mund të përdorni lodra të ndryshme duke i ndarë ato në disa kategori psh; përmes ngjyrës, madhësisë dhe t'ia mësoni fëmijës këto koncepte. Fëmija juaj nuk do jetë në gjendje ti kategorizoj lodrat që në fillimi, për këtë arsye si ka nevojë për ndihmën tuaj. Stimuloni fëmijën sa herë që ai e kryen sakt një veprim. Ndiqni mënyrën se si fëmija juaj i përdor lodrat dhe kur është e nevojshme imitojeni dhe ju atë. Do të ndodhë që fëmija juaj ti hedhë lodrat, t'i vendos ato në gojë etj.

Edhe pse fëmija juaj ka një vështirësi ai mund të luaj, përdoreni lojën për ta kuptuar atë dhe për t'i mësuar disa aftësi të tilla si : aftësitë imituese, eksploruese, gjuhësore etj.

Loja dhe fëmijët me autizëm

Fëmijët me autizëm zakonisht kanë interesa të kufizuara ndaj disa objekteve si lodrave me muzikë, preferojn një ngjyrë specifike e cila tërheq vëmendjen e tyre (në përgjithësi këto janë ngjyrat e forta si e kuqe, blu, e verdhe etj). Ata nuk luajnë për një kohë të gjatë me një objekt të caktuar dhe gjithashtu rrallë i përdorin objektet në varësi të funksionit, kështu psh: mund ta mbajnë topin në duar, ta rrotullojnë atë por nuk e hedhë ose i gjuan atij. Fokusohen në element të veçantë të lodrave që kanë në duar si rrotat e makinës të cilat i rrotullojnë në mënyrë të përsëritur. Loja e tyre është e përsëritur dhe ndodh që të rendisin lodrat që kanë në duar. Nuk përfshihen në lojë me fëmijët e tjerë, zakonisht distancohen drejt një vendi të veçantë. Në rastet kur mjedisi është i vogël ata ulen me fëmijët e tjerë, por luajnë vetëm.

Si mund të luajmë me një fëmijë me autizëm:

Aftësitë në lojë të një fëmije me autizëm shërbejnë si një dritare për të kuptuar se çfarë ata dinë. Lodrat dhe objektet mund të përdoren në mënyrë mekanike dhe të papërshtatshme nga fëmija. Përsëritja e lojës na tregon rreth një të kuptuari të limituar se si lodra përdoret në mënyrë të përshtatshme.

Së pari, duhet të kuptojmë interesat e fëmijës, cilat janë lodrat dhe lojrat e tij të preferuara. Gjithmonë duhet të ndjekim preferencat dhe lojën e fëmijës për ti tërhequr atij vëmendjen. Duhet të dimë se fëmijët me autizëm pëlqejnë strukturën dhe rutinat, ata kanë nevojë të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë, për këtë arsye dhe loja duhet tu përgjigjet strukturave dhe rutinave të fëmijës. Nëse ju i paraqisni atij diçka të re, atëherë ai do të frustrohet dhe do të përfshihet në sjellje të papërshtatshme. Kjo ndodh pasi fëmijës suaj i duhet më shumë kohë të kuptojë se çfarë duhet të bëjë me objektin dhe veten e tij dhe kjo mund të çojë në rritjen e ankthit dhe në "sjellje të papërshtatshme".

Disa lojra që ju mund të zhvilloni me fëmijën janë:

Lojrat senso- motore.

Ofronini fëmijës suaj lodra të tilla si, kuba, lodra me muzikë, flluska, tullumbace, top, loj me ujë, bojra, plastelin etj. Gjithashtu përpunoni të organizoni sa më shumë lojra në oborrin e shtëpisë ose në parqe të tilla si, të vraponi, kërceni, luani roza-rozina, kuka-fshehti etj. Të gjitha këto lojra ndihmojnë në nxitjen e ndërveprimit social. Lojrat sensore janë të rëndësishme pasi nëpërmjet tyre fëmija mëson të mbajë rradhën, të përqëndrohet, të ketë kontakt me sy, të degjoj etj. Edhe pse ju duket se fëmija nuk arrin të zbatoj siç duhet këto lojra ju duhet të vazhdoni të luani dhe ta ndihmoni fëmijën për të eksploruar dhe kuptuar mjedisin rrethues.

Lojrat ndërtuese.

Këto lojra u mësojnë fëmijëve shkakun dhe pasojën. Nëse fëmija bën diçka me lodrat e tij si të shtyp, ta hedhë, ta prekë atë, atëherë diçka do të ndodhë. Fëmija duhet të ndihmohet që ta kuptojë këtë, dhe gjithashtu ju duhet ta stimuloni atë gjatë kësaj fazë të hershme.

Loja pretenduese

Fëmijët me autizëm duhet të mësojnë të imitojnë personat e tjerë. Ne të gjithë fillojmë të mësojmë përmes imitimit. Fëmijët mësojnë se si të sillen ndaj situatave duke imituar prindërit e tyre. Kjo është një fazë e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve. Mos prisni që fëmija juaj t'ju imitojë në mënyrë të pavaruar. Do të duhet të fillosh ti i pari që të imitosh atë. Imitoni mënyrën se si ai luan, tingujt dhe lëvizjet e tij dhe vëreni nëse ai/ajo po ju shikon. Kështu psh: nëse fëmija juaj vrapon rreth dhomës, vraponi dhe ju pas tij; nëse fëmija juaj vendsos dy kuba sipër njëri- tjetrit bëni dhe ju të njëjtin veprim.

Pse duhet tu mësojmë fëmijëve me autizëm të luajnë:

- Tu mësojmë fëmijëve me autizëm të luajnë me bashkëmoshatarët është jetike për suksesin e tyre social.
- I lejonë fëmijës të zhvillojë aftësi të reja në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.
- Mungesa e lojës mund të çojë në izolim social të fëmijës.
- Loja i ndihmon ata të lidhin ndjenjat dhe mendimet me ngjarjet specifike. Fëmijët me autizëm

e kan të vështirë të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre. Loja i ndihmon ata të lidhin mendimet dhe ndjenjat me ngjarjet duke i lejuar të shprehin kështu emocionet e tyre.

Loja dhe fëmijët hiperaktiv.

Fëmijët me ADHD zakonisht kanë vështirësi në funksionet egzekutive, në aftësinë për të menduar dhe zbatuar plane, organizuar, kontrolluar impulset dhe aftësit për të përfunduar një detyrë. Studimet kanë treguar se lojrat fizike dhe në natyrë ndihmojnë fëmijët hiperaktiv të jenë më të përqëndruar dhe gjithashtu në egzekutimin saktë të detyrave. Organizoni sa më shumë lojra si kërcimi, vrapimi, lojra me top etj.

10. Edukimi dhe edukatorët në raport me fëmijën dhe lojën.

Loja tradicionale në sistemin e edukimit parashkollor është konsideruar si shprehje e veprimeve të fëmijës dhe mënyra se si ata krijojnë kuptimet e tyre (Vygotsky, 1995; Corsaro, 1997)²². Loja është një aspekt shumë i rëndësishëm në punën me fëmijët veçanërisht gjatë frekuentimit të çerdhes. Në këtë fazë e vetmja metodë nëpërmjet të cilës fëmijët mund të mësojnë koncepte dhe të formojnë kuptime është loja. Loja është parë si një mënyrë natyrale përmes të cilës fëmija vepron në mjedisin rrethues (cf. Dahlberg & Lench Taguchi, 1994)²³. Përgjegjësia e mësuesve përkundrejt lojës së fëmijës është të stimulojë dhe jo ta pengojnë atë.

Edukatorët nuk duhet të harrojnë se qëllimi në vetëvete i lojës është që të ofrojë kënaqësi dhe të mësuarit përmes kënaqësisë stimulon disa atësi të fëmija të tilla si imagjinatën, empatinë, komunikimin, të menduarit simbolik si dhe aftësitë sociale dhe në zgjidhjen e problemeve (Department of Education, 1998a, p. 9)²⁴. Edukatorët nuk duhet të pengojnë dëshirën e fëmijëve për të luajtur dhe për të shprehur kulturën e tyre përmes lojës. Edukatorët duhet të jenë njohës shumë të mirë të rëndësisë së lojës në zhvillimin e fëmijëve dhe mënyrës se si ata luajnë.



Disa këshilla për edukatorët në organizimin e aktiviteteve me fëmijët në çerdhe:

Në manualin *"Strategji të provuara dhe testuara: loja dhe të nxënësit në moshën e hershme"* të publikuar nga A. Glenn, J. Cousins dhe A. Helps (2006)²⁵ kemi vendosur të shkëpusim disa këshilla që mendojmë se janë të vlefshme dhe do të ndihmojnë edukatorët në çerdhe në lidhje me organizimin e lojrave dhe aktiviteteve të ndryshme me fëmijët në grup ose edhe në oborrin e çerdhes.

- Sigurohuni që aktivitetet e planifikuara të kenë lidhje me eksperiencat e fëmijëve
- Kur planifikoni aktivitete për të ndërtuar koncepte të tilla si përmasat, forma, lartësia, pesha, merrni në konsideratë sa më shumë që të jetë e mundur organizimin e aktivitetit në ambientet e jashtme.
- Bëjini këto aktivitete sa më argëtuese që të jetë e mundur, p.sh. gjeni krimbin më të gjatë, kërmillin më të madh, gurin më të rëndë, pellgun më të thellë.
- Kur planifikoni aktivitete krijuese, merrni në konsideratë përdorimin e formave të natyrës, p.sh. gjethet, petalet, rrjetat e merimangave, guaskat, pendët.

²²Vygotsky, L. (1995) *Fantasiochkreativitet i barndomen*; Corsaro, W. (1997) *The sociology of childhood*.

²³Dahlberg, G. & Lench Taguchi, H. (1994), *Preschool and school—about two different traditions and the vision of a meeting*.

²⁴Department of Education (1998a) *Curriculum for preschool*.

²⁵ "Strategji të Provuara dhe Testuara: Loja dhe të Nxënësit në Moshën e Hershme. Një Metodë Gjithpërfshirëse".

²⁴ Tema: "Fëmijët dhe loja. Si të luani me fëmijën tuaj që ai/ajo të mësojë?" / A. Xhemali dhe J.Çeça

- Përdorni rregulla shumë të qarta në mënyrë që fëmijët të dinë se çfarë pritet prej tyre.
- Planifikoni hapësira të ndryshme dhe ndajini mjediset jashtë dhe brenda p.sh. zonat e qeta përjashta, zonat e vrapit dhe flakjes, zonat e gërmimit, zonat e ndërtimit, zonat shqisore, zonat kreative, zonat e lojës simuluese.
- Planifikoni aktivitete që janë të mundura të organizohen si në mjediset e brendshme ashtu edhe në mjediset e jashtme në mënyrë që fëmijët të mos bëjnë një dallim të ndërgjegjshëm midis ‘të mësuarit, që ndodh në mjediset e brendshme me praninë e një të rrituri’ dhe ‘lojës, që bëhet përjashta me shokët’.
- Përdoreni në mënyrë të natyrshme hapësirën përjashta për të organizuar kohën e përrallave, kohën në grup, vizatimin, numërimin, shkrimin etj.
- Ndërtoni hapësira loje me rërë dhe ujë përjashta ku çdo rrëmujë mund të pastrohet lehtësisht.

Burimet:

1. **Angela Glenn, Jacquie Cousins dhe Alicia Helps. (2006)** "Strategji të Provuara dhe Testuara: Loja dhe të Nxënërit në Moshën e Hershme. Një Metodë Gjithëpërfshirëse". (Save the Children) fq 55- 56.
2. **David Whitebread & Dave Neale, Hanne Jensen, Claire Liu & S. Lynne Solis, Emily Hopkins & Kathy Hirsh-Pasek and Jennifer Zosh. (2017).** *The role of play in Children's development: A review of the evidence*, Isbn: 978-87-999589-3-1
3. **Edwards, S. (2017).** *Play-based Learning and Intentional Teaching: Forever Different?* *Australasian Journal of Early Childhood*, 42(2), 4- 1. <http://dx.doi.org/10.23965/AJEC.42.2.01>
4. **Emslie, A., & Mesle, C. (2009).** *Play: The use of play in early childhood education.* *Gyanodaya: The Journal of Progressive Education*, 2, 1-26. Doi: 0974-1801.
5. **Fisher, K., Hirsh-Pasek, K., Golinkoff, R. M., Singer, D. G., and Berk, L. (2011).** *Playing around in school: Implications for learning and educational policy.* In A. D. Pellegrini (Ed.), *Oxford Handbook of the Development of Play.* Oxford University Press.
6. **Gabriela Bento, Gisela Dias, (2017),** "The importance of outdoor play for young children's healthy development". (<http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/>).
7. **Goldstein, J. (2012).** *Play in Children's Development, Health, and well-being.* <http://www.ornes.nl/wp-content/uploads/2010/08/Play-in-children-s-development-healthand-well-being-feb-2012.pdf>.
8. **Hall, N. (1991).** *Play and the emergence of literacy.* In J. F. Christie (Ed.), *Play and Early Literacy Development.* Albany: State University of New York Press.
9. **Jeffrey Goldstein (2012),** *Play in children's development, health and well-being.* <https://www.ornes.nl/2010/08/>.
10. **Mead, S. (n.d.).** *How Do Children Learn Through Play?* [Blog]. <http://www.ornes.nl/wp-content/uploads/2010/08/Play-in-children-s-development-healthand-well-being-feb-2012.pdf>.
11. **Miller, E., Almon, J. (2009).** *Crisis in Kindergarten: Why Children Need Play in School* http://www.allianceforchildhood.org/sites/allianceforchildhood.org/files/file/kindergarten_report.pdf.
12. **Moyer, K.E., von Haller Gilmer, B. (1955).** *Attention Span of Children for Experimentally Designed Toys.* *Journal of Genetic Psychology*, 87(2), 187-201. <https://doi.org/10.1080/00221325.1955.10532930>.
13. **S. Frojd,** "Përtej parimit të kënaqësisë" (1920), shkëputur nga c.l. Musati, Boringhieri; Torino 1974, pp 200-203
14. **Schulz, Laura E., Standing, Holly R., and Bonaëitz, Elizabeth B. (2008).** *Word, thought, and deed: The role of object categories in children's inductive inferences and exploratory play.* *Developmental Psychology*, 44, 1266-1276.
15. **Slutsky, R, DeShetler, L.M. (2016).** *How technology is transforming the way in which children play.* *Early Child Development and Care*, 18(7), 1138-1146. <https://doi.org/10.1080/03004430.2016.1157790>.
16. **Smith, P.K. (2013).** *Play: Synthesis.* In *the Encyclopedia of Early Childhood Development [online]*, 1- 3.
17. **T. Armstrong. (2015).** *What Children's Play is not.* <http://www.institute4learning.com/2015/10/28/what-childrens-play-is-not/>.
18. **Ungerer, J. A., and Sigman, M. (1986).** *The relation of play and sensorimotor behaviour to language in the second year.* *Child Development*, 55, 1448-1455.
19. **UNICEF and Lego Foundation, (2018),** *Learning through play Strengthening learning through play in early childhood education programmes*, pg. 7.
20. **Whitman, Elizabeth,** "The Impact of Social Play on Young Children" (2018). *Integrated Studies*. 94. <https://digitalcommons.murraystate.edu/bis437/94>.
21. <http://asha.org>, E. Lash and P. Mçoy, . W.V autism training center at Marshall University, *Play and Autism*.